

Mbi auditimin e ushtruar në Degën Doganore Rinas

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën Doganore Rinas me objekt “Mbi realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacionit doganor” dhe për auditimin e insitucionit për vitin 2009 dhe 2011. Masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.84, datë 06/06/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 119/6, datë 06/06/2012 dërguar Z. Gëzim Demushi, Kryetar i Degës Doganore Rinas, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Masa organizative

1. Autoriteti doganor kompetent të analizojë me të gjithë stafin Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin janë paraqitur rast pas rasti shkeljet e konstatuara, njëkohësisht të përgatisë një program pune të veçantë me persona përgjegjës, për zbatimin e rekomandimeve të dërguara, bashkëlidhur këtij raporti

Menjëherë

2. Dega e Doganës Rinas në bashkëpunim me DRD dhe DOH të bëjnë verifikimin e faturave blerjes të zhdoganuara për vitin 2012, subjektet “██████” dhe “██████” shkeljet e konstatuara të vlerësohen në mënyrë të detajuar, detyrimet të arkëtohen në buxhetin e Shtetit rast pas rast.

Vazhdmisht

3. Të përmirësohet më tej puna organizative për arkëtimin e detyrimeve debitore që lindin nga veprimtaria kontrolluese pas kryerjes së ç’doganimit, në periudhë kohore sa më të shkurtër, në respektim të vazhdueshëm të dispozitave ligjore, pa kaluar si detyrim në borxh.

Vazhdmisht

4. Të vendosen kritere limit për sasi mallrash të kufizuara që ç’doganohen në terminal, në formë bagazhesh, për një subjekt apo individ, për një kalim ose për periudhë kohore të caktuar, me qëllim rritjen e arkëtimit të detyrimeve doganore dhe shmangjen e faktorëve subjektiv të mundshëm.

Menjëherë

B. Masa Zhdëmtimi

1. Subjekt privat që ka zhdoganuar duke mos zbatuar rregullat e kodit doganor. Si rezultat subjekti detyrohet 921,713 lekë.

Brenda datës 30/06/2012

2. Të pregatitet dhe të dërgohet dokumentacioni ligjor për verifikim të mëtejshëm DPD dhe DOH, mbështetur në ligjin nr 8449, datë 27.01.1999 “ Kodi Doganor neni 102 pikat 1,2,3 me ndryshimet si dhe udhëzimet të dala në zbatim të ligjit për mallrat të aplikuar trasaksionin (faturë) ku është më i ulët se çmimi referues që ndodhet në dosjen me të dhënat e disponueshme në Republikën e Shqipërisë si dhe zbatim të udhëzimit nr 1 datë 27 .01 2006 “ mbi shqyrtimin e vlerës doganore” pika 2.

Brenda datës 30/06/2012

3. Mbas verifikimit të kryhen veprimet ligjore, saktësimi, kontabilizimi dhe arkëtimin e detyrimeve për subjektet privatë që kanë kryer shkeljet e mësipërme.

C. Masa Disiplinore

Në zbatim të Kreut 6 “Shkeljet dhe masat disiplinore”, me ligjin nr. 8599, datë 11/11/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, nenit 16, pika 16.1 germa “a” të Vendimit të KM nr. 205 datë 13/04/1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganorë”, ndryshuar me Vendimin e KM nr. 686, datë 02/11/2005 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave” të ndryshuar, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore “Humbje e së drejtës së shpërblimeve për 1 (një) vit, neni 16, pika 18.1.4 germa “a” për dy punonjës, për moszbatim të ligjit nr. 8449, datë 27/01/1999 “Kodi Doganor” nenet 11, 23 dhe 34-39. dhe të kërkesave të Vendimin e KM nr. 205, datë 13/04/1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe për moszbatim të ligjit nr. 8449, datë 27/01/1999 “Kodi Doganor” nenet 11, 23 dhe 34-39. dhe të kërkesave të Vendimit të KM nr. 205, datë 13/04/1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit z. Faik Qosja, përgjegjës grupi, z. Odhise Veshi, anëtar, z. Hysen Metko, anëtar. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit z. Kristaq Gjurgjaj, Drejtori i Departamentit z. Kristaq Gjurgjaj dhe Drejtori i Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.